

Berliner Ferienschulen përfaqëson një ofertë për kohën e pushimit, e cila u adresohet fëmijëve dhe të rinjve që nuk flasin ose nuk ndjehen të sigurt kur flasin gjermanisht. Vajzat dhe djemtë mësojnë gjermanisht në grupe deri në 15 njerëz. Përveç mësimet të gjuhës gjermane, ata do të merren me aktivitete sportive, kulturore apo kreative gjatë pushimit shkollor.

Grupet koordinohen nga organizata në gjithë Berlinin. Oferta për kohën e pushimit përbëhet nga gjashtë orësh në ditë gjatë një periudhe dyjavore në pushimin e Pashkës dhe pushimin e vjeshtës dhe gjatë një periudhe prej dy deri në gjashtë javë në pushimin veror.

Fëmijët dhe të rinjtë do të zbulojnë interesa dhe aftësi të reja përmes workshop-eve sportive dhe kreative dhe gjithashtu, duke eksploruar qytetin. Përveç mësimet, ata do të kenë mundësi të njihen me klube sportive, qendra për kalimin e kohës së lirë dhe pika të rëndësishme të kontaktit në Berlin, duke lidhur miqësi të reja.

Pjesëmarrja në shkollën verore është e lirë. Për t'u regjistruar në një grup studimor, fleta **Ftesë për të marrë pjesë në një ofertë për kohën e pushimit** duhet të plotësohet dhe t'i dorëzohet organizatorit përkatës.

Ju lutemi të keni parasysh: *Berliner Ferienschulen* përfaqësojnë një ofertë të njohur për fëmijët dhe të rinjtë që duan të përmirësojnë njohuritë e gjermanishtes gjatë pushimeve. Nuk mund të garantohet një vend për çdo fëmijë dhe të ri të interesuar. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që pjesëmarrësit e regjistruar të ndjekin rregullisht mësimet dhe aktivitetet e shkollës verore, që të mos mbeten të pazëna vende që ndryshe do t'u ofrohen fëmijëve dhe të rinjve të tjerë.

Berliner Ferienschulen koordinohet nga Fondacioni Gjerman për Fëmijët dhe Rininë. Për më shumë informacion, shikoni: <http://www.dkjs.de/ferienschulen/>

Ftesë për të marrë pjesë
në një ofertë pushimi



Sprachförderung,
Bildung und Teilhabe
für geflüchtete Kinder
und Jugendliche

A je ti në moshë midis 12 dhe 16 vjeç(e)?

Të ftojme, së bashku me moshatarët e tu, që të marrësh pjesë në ofertën tonë të pushimit që nga **9.7.2018** deri më **20.7.2018**.

Së bashku, do të mësojnë gjermanisht, do të zbulojmë Berlinin dhe do të jemi kreativë!

pushimet shkollore: **in NEUKÖLLN**

Adresa: **KIJUFI, Am Sudhaus 2, 12053 Berlin-Neukölln**

Personi i kontaktit: **Lora Nikolova**

Numri i telefonit për pyetjet: **Büro: 030 60 98 86 55 / Mobil: 0177 70 56 944**

Posta elektronike: **lora.nikolova@kijufi.de**



Regjistrimi i pjesëmarrësve në moshë nën 18 vjet

NEUKÖLLN / 9.7.-20.7.2018

Unë dëshiroj të regjistrohem për të marrë pjesë në ofertën e pushimeve në mënyrë të rregullt:

Emri: _____

Mosha: _____

Adresa: _____

Personi i kontaktit i pjesëmarrësit: _____

Numri i telefonit i personit të kontaktit: _____

Unë jam dakord me pjesëmarrjen e fëmijës së lartpërmendur në ofertën e pushimit (duke përfshirë udhëtimet dhe aktivitetet).

Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar

Në rast që fëmija nuk mund të marrë pjesë (p.sh. për shkak të ndryshimeve në planet e pushimit ose në rast sëmundjeje), do të njoftoj organizatorin menjëherë, me qëllim që një fëmijë ose i ri tjetër të ketë mundësi të marrë pjesë në ofertë.